# FLETORJA ZYRTARE

# E

# REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

**Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare**

| Nr. 74 | 2002 | Nëntor |
|---|---|---|

P Ë R M B A J T J A


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Dekret nr. 3548 datë 8.11.2002 | Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare …….. | 2055 |
| Dekret nr. 3549 datë 8.11.2002 | Për lejim lënie të shtetësisë shqiptare …….. | 2055 |
| Dekret nr. 3556 datë 14.11.2002 | Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme në zonën zgjedhore nr. 52 ……. | 2056 |
| Vendim i KM nr. 540, datë 31.10.2002 | Për kuotat financiare të ushqimit në mensat e konvikteve, bursat e shtetit dhe pagesat e familjeve të nxënësve, studentëve, fëmijëve që pranohen në shtëpitë e fëmijës, në Institutin e fëmijëve që nuk dëgjojnë, në Institutin e fëmijëve që nuk shikojnë dhe në Institutin e fëmijëve me prapambetje të lehtë mendore…….. | 2057 |
| Vendim i KM nr. 542, datë 31.10.2002 | Për miratimin e statutit të Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja | 2062 |

| | | |
|---|---|---|
| | (ANIH)……. | |
| Vendim i KM nr. 543, datë 31.10.2002 | Për akreditimin e institucioneve të arsimit dhe formimit profesional (AFP)…… | 2068 |
| Vendim i KM nr. 544, datë 7.11.2002 | Për disa ndryshime në rregulloren "Produktet e mbrojtjes së bimëve", miratuar me vendimin nr. 72, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave……. | 2069 |
| Vendim i KM nr. 549, datë 7.11.2002 | Për një ndryshim në vendimin nr. 277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave "Për përfitimet nga statusi i të verbërit"…… …… | 2070 |
| Vendim i KM nr. 551, datë 7.11.2002 | Për klasifikimin e funksioneve dhe grupimin e njësive të qeverisjes vendore, për efekt page, e për caktimin e kufijve të pagave të punonjësve të organeve të qeverisjes vendore…… ……. | 2070 |
| Vendim i KM nr. 554, datë 7.11.2002 | Për një shtesë në rregulloren "Për etiketimin e produkteve ushqimore", të miratuar me vendimin nr. 604, datë 17.11.2000 të Këshillit të Ministrave……. | 2075 |
| Vendim i KM nr. 555, datë 7.11.2002 | Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Suedisë për projektin "Mbështetje për zhvillimin e regjistrit të statistikave të biznesit dhe përdorimin e tyre në hartimin e llogarive kombëtare"……. | 2075 |
| Vendim i KM nr. 556, datë 7.11. 2002 | Për shkëmbimin e vilës nr. 55, pronë e Shtetit Shqiptar, me vilën nr. 6, pronë e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut…….. | 2079 |
| Vendim i KM nr. 559, datë 7.11.2002 | Për miratimin e lejes së funksionimit të institucionit arsimor, jopublik, "Amaro Tan"…… | 2080 |
| Vendim i KM nr. 564, datë 13.11.2002 | Për miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Rumanisë për bashkëpunimin në fushën sanitare veterinare…… …….. | 2080 |
| | *Kërkesë* për shpallje të vdekur të shtetasve Muhamet Rexhepi, Sami Rexhepi, Fatime Rexhepi, Mihase Rexhepi e Lutfije Rexhepi…… | 2083 |

**D E K R E T**
**Nr. 3548, datë 8.11.2002**

**PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Mariana Niko Grazhdani
2. Samanta Sasa Grazhdani
3. Arben Hyso Hysaj
4. Përparim Zhafer Maloku
5. Vjollca Mehmet Tafa (Hasa)
6. Klaudia Fatmir Tafa
7. Angelo Fatmir Tafa
8. Servet Feim Fishekaj
9. Aldo Servet Fishekaj
10. Christ Servet Fishekaj
11. Liljana Azem Fishekaj (Bebeci)
12. Vangjush Niko Koça
13. Pranvera Elmas Koça (Skënduli)
14. Ortenca Vangjush Koca
15. Isida Vangjush Koça
16. Elmas Hajdar Musaku
17. Fleanc Elmas Musaku
18. Hajdar Elmas Musaku
19. Drita Qerim Musaku (Gjoshi)
20. Agron Ramazan Hysa
21. Luan Myftar Bej
22. Lindita Dizdar Jahn (Dizdari)
23. Erjola Luan Hafizllari
24. Bujar Bato Bastriu
25. Flamur Vesel Bufi
26. Ertis Flamur Bufi
27. Cornelia Flamur Bufi
28. Rudina Riza Bufi (Mumajesi)
29. Aleksandër Alush Durmishi
30. Zhirar Xhovasar Çakmaxhian
31. Stui Zhirar Çakmaxhian
32. Ester Zhirar Çakmaxhian
33. Iris Jovan Çakmaxhian (Grabovari)

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Alfred Moisiu**

**D E K R E T**
**Nr. 3549, datë 8.11.2002**

**PËR LEJIM LËNIE TË SHTETËSISË SHQIPTARE**

Në mbështetje të nenit 92 pika "c" të Kushtetutës, të neneve 15, 19 dhe 20 të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998 "Për shtetësinë shqiptare", bazuar edhe në propozimin e Ministrit të Rendit Publik,

D E K R E T O J:

Neni 1

U lejohet lënia e shtetësisë shqiptare me kërkesë të tyre personave të mëposhtëm:

1. Artin Jusuf Grobmann (Gjakova)
2. Mark Rok Kola
3. Maja Nazmi Kola (Ymeri)
4. Afërdita Ramadan Loos (Dyli)
5. Gëzim Sabri Bebeti
19. Luçia (Lucie) Llesh Wupper-Zadeja
20. Flutura Haxhi Noka (Kaimi)
21. Viola Esat Noka
22. Pajtim Nazmi Drini
23. Endi Pajtim Drini

6. Migen Gëzim Bebeti
7. Engjëll Gëzim Bebeti
8. Mirela Pirro Bebeti (Ferro)
9. Gëzim Ndrea Gjini
10. Vasilika Vasil Gedyk (Koka)
11. Arben Hiqmet Bazhaja
12. Julian Arben Bazhaja
13. Manjola Rustem Bazhaja (Pasmaçiu)
14. Noel Kel Ashta
15. Ekaterina Mihal Toska (Ciko)
16. Shpëtim Stavri Qeleshi
17. Erika Shpëtim Qeleshi
18. Adrian Zija Çeliku
24. Suada Pajtim Drini
25. Merita Emin Drini (Meta)
26. Kujtim Zyhdi Hushi
27. Sokol Zyhdi Hoxha
28. Eva Irakli Peters (Rafail)
29. Beglie Ethem Luzha (Haka)
30. Leonora Enver Luzha
31. Besart Enver Luzha
32. Bashkim Hasan Musliaj
33. Teuta Xhemal Pfisteres (Kaçurri)
34. Ibrahim Qazim Memaçi
35. Mario Ibrahim Memaçi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Alfred Moisiu**

**D E K R E T**
**Nr. 3556, datë 14.11.2002**

**PËR CAKTIMIN E DATËS SË ZGJEDHJEVE TË PJESSHME NË ZONËN ZGJEDHORE NR. 52**

Në mbështetje të nenit 92 germa "gj" të Kushtetutës, si dhe të neneve 4 dhe 11, pika 3 të ligjit nr. 8609, datë 8.5.2000 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", bazuar në njoftimin e Kryetarit të Kuvendit,

D E K R E T O J:

Neni 1

Zgjedhjet e pjesshme për deputet në zonën zgjedhore nr. 52 të zhvillohen ditën e dielë, datë 15 dhjetor 2002, ndërsa raundi i dytë zhvillohet ditën e dielë, datë 29 dhjetor 2002.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
**Alfred Moisiu**

**V E N D I M**
**Nr. 540, datë 31.10.2002**

**PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSAT E KONVIKTEVE, BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E FAMILJEVE TË NXËNËSVE, STUDENTËVE, FËMIJËVE QË PRANOHEN NË SHTËPITË E FËMIJËS, NË INSTITUTIN E FËMIJËVE QË NUK DËGJOJNË, NË INSTITUTIN E FËMIJËVE QË NUK SHIKOJNË DHE NË INSTITUTIN E FËMIJËVE ME PRAPAMBETJE TË LEHTË MENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 7 të ligjit nr. 8718, datë 19.12.2001 "Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2002", të shkronjës "c" të nenit 32 të ligjit nr. 8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 63 të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Studentëve dhe nxënësve u jepet bursë ose gjysmëbursë dhe përfitime të tjera, të parashikuara në këtë vendim, çdo vit, nga buxheti i miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.

2. Bursë ose gjysmëbursë përfitojnë:

a) nxënësit dhe studentët që vazhdojnë studimet larg vendbanimeve të tyre dhe plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrave nr.1 dhe nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi;

b) nxënësit që banojnë në fshat, të cilët nuk kanë shkollë 8-vjeçare brenda rrezes prej 5 km ose transport të siguruar e që vendosen në konvikt;

c) nxënësit dhe studentët që kanë përfituar statusin e jetimit në të gjitha kategoritë e shkollave;

ç) studentët e divorcuar;

d) secili nga studentët bashkëshortë që ka fëmijë;

dh) nxënësit dhe studentët, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë.

Nxënësit dhe studentët që trajtohen me bursë ose gjysmëbursë, sipas shkronjave "c", "ç", "d", e "dh" e përfitojnë atë edhe gjatë pushimeve verore.

e) studentët që vazhdojnë studimet në Universitetin e Tiranës, në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, në degët Matematikë e Fizikë;

Studentët, që kanë përfituar bursë sipas këtij kriteri, trajtohen deri në përfundim të studimeve, jashtë kriterit ekonomik.

Për këtë kategori studentësh, bursat shpërndahen nga Universiteti i Tiranës, Fakulteti i Shkencave të Natyrës, sipas planit të miratuar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës, në përputhje me kuotat e pranimit, të miratuara nga Këshilli i Ministrave për këto degë.

ë) nxënësit në arsimin e mesëm profesional, që kanë mbaruar vitin shkollor paraardhës me të gjitha notat 10-ta, marrin bursë të plotë;

f) studentët që kanë mbaruar vitin akademik paraardhës me të gjitha notat 10-ta, marrin bursë të plotë;

g) studentët e viteve të dyta e lart, që plotësojnë kriteret ekonomike jashtë bursave të ndërmjetme të universiteteve, përfitojnë bursë sipas planit të shpërndarjes, të hartuar nga Drejtoria Ekonomike e Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, për të gjitha universitetet, brenda numrit të bursave të vitit të parë, të miratuara me këtë vendim. Numri i bursave për këtë kategori studentësh është deri në 100.

3. Bursë ose gjysmëbursë nuk përfiton:

a) nxënësi dhe studenti i familjes, që ushtron veprimtari private, sipas dispozitave ligjore në fuqi;

b) nxënësi dhe studenti i ndarë nga trungu familjar.

Për efekt trajtimi me bursë, merren për bazë të ardhurat ekonomike të të gjithë familjes nga e cila është ndarë nxënësi apo studenti dhe certifikata familjare para ndarjes.

c) më shumë se një person në familje, përveç rasteve të parashikuara në shkronjën "ç", "d", "dh" dhe "f" të pikës 2 të këtij vendimi;

ç) nxënësi i shkollës 8-vjeçare, të mesme dhe studenti që nuk e merr klasën apo vitin;

d) studenti që vazhdon studimet me kuotë dytësore.

4. Studentët, pavarësisht nga kriteret, nuk mund të përfitojnë bursë apo gjysmëbursë më tepër se vitet e shkollimit, të përcaktuara në planin mësimor në degën përkatëse.

5. Këshillat e qarqeve, me propozimin e këshillave të komunave dhe të bashkive, kanë të drejtë të miratojnë bursë ose gjysmëbursë për vitin e parë jashtë kritereve të përcaktuara në këtë vendim, brenda planit të vitit të parë, ku për çdo rreth planifikohen jo më shumë se 3 bursa. Këshilli Bashkiak i Tiranës ka të drejtë të japë deri në 30 bursa. Këto bursa duhet të nënshkruhen, për efekt plani, edhe nga drejtori i drejtorisë arsimore përkatëse.

Nxënësi dhe studenti e përfiton këtë bursë gjatë gjithë viteve të planifikuara të shkollimit. Në rastet kur nxënësi ose studenti, që përfiton këtë lloj burse, ndërpret shkollën për arsye të ndryshme, i humbet e drejta e përfitimit të bursës.

Nxënësve dhe studentëve u ruhet bursa kur humbasin vitin shkollor për arsye shëndetësore ose fatkeqësi familjare.

6. Bursistët jetimë të shtëpive të fëmijës, të shkollave të mesme dhe të larta, nxënësit e Institutit të fëmijëve që nuk shikojnë dhe nxënësit e Institutit të fëmijëve që nuk dëgjojnë përfitojnë falas veshmbathje, libra, fletore, sipas normave të përcaktuara në natyrë, sipas pasqyrës nr. 5, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Këto kategori nxënësish përfitojnë falas nga shteti shërbimin mjekësor, në kuotën deri në 200 lekë në muaj për nxënës, si dhe shërbimin shëndetësor dentar.

Kuotat e ushqimit dhe të shpenzimeve të vogla, për nxënësit e institucioneve të arsimit special, me konvikt, të jetë sipas pasqyrës nr.5/1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Fëmijët e institucioneve të arsimit special, pa konvikt, trajtohen falas nga shteti me një vakt ushqimi (drekë) dhe me mjete shkollore. Kuota ushqimore për këtë kategori nxënësish është 70 lekë në ditë.

Mësuesit dhe edukatorët e institucioneve të mësipërme gëzojnë të drejtën e një vakti (drekë) me vlerë deri në 70 lekë në ditë. Kuota financiare ushqimore ditore për studentët të jetë sipas pasqyrës nr. 7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Nxënësve dhe studentëve jetimë, bursistë, u jepen lekë në dorë për nevoja vetjake, përkatësisht 500 dhe 700 lekë në muaj. Këtë të drejtë e gëzojnë edhe kur kurohen në institucionet shëndetësore.

7. Niveli i bursave dhe i kuotave financiare të ushqimit për të gjitha kategoritë e shkollave, të jetë sipas pasqyrave nr. 3 dhe nr. 4 "Për nivelin e bursave dhe të kuotave financiare ditore", që i bashkëlidhen këtij vendimi. Kuota ushqimore për nxnënësit dhe studentët në lekë të jetë sipas pasqyrës nr. 6, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe kuota financiare, në natyrë për ushqim, e studentëve të jetë sipas pasqyrës nr.7, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Bursa ose gjysmëbursa për studentët jepet me lekë në dorë.

Bursa ose gjysmëbursa për vitet e para të shkollave 8-vjeçare, të mesme dhe të larta miratohet me vendim të këshillit bashkiak apo të këshillit të komunës, ku ka vendbanimin e përhershëm nxënësi apo studenti, si dhe nga prefektura përkatëse.

8. Drejtoritë arsimore në rrethe bëjnë shpërndarjen e planit të bursave, duke përfshirë edhe bursat jashtë kriterit, që miratohen nga këshillat e qarqeve apo nga Këshilli Bashkiak i Tiranës, brenda planit të vitit të parë.

Bursat ose gjysmëbursat për nxënësit dhe studentët e të gjitha niveleve për vitet e para, të nënshkruhen, për efekt plani, edhe nga drejtori i drejtorisë arsimore përkatëse, në përputhje me planin e dërguar nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës. Vendimin origjinal të dhënies së bursës studentit apo nxënësit, bashkia apo komuna ia dërgojnë, në rrugë zyrtare, drejtorisë arsimore përkatëse. Bashkia apo komuna i dërgon, po në rrugë zyrtare, vendimet përkatëse dhe listën e bursistëve në shkolla dhe universitete dhe një kopje në Drejtorinë Ekonomike të Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës. Asnjë dokument zyrtar nuk i jepet në dorë personit të interesuar për bursë.

Bursa e studentëve të vitit të parë të shpërndahet vetëm pasi të jenë dërguar zyrtarisht listat nga drejtoritë arsimore përkatëse.

Bursat ose gjysmëbursat për nxënësit dhe studentët e viteve të dyta e lart të rishqyrtohen e të miratohen nga vetë shkollat dhe universitetet ose nga institucionet përkatëse.

9. Ministrisë së Arsimit dhe të Shkencës, për vitin shkollor 2002-2003, i jepen 900 bursa për arsimin e mesëm dhe 1 100 bursa për arsimin e lartë. Planshpërndarja e bursave për çdo rreth bëhet sipas kërkesave të ardhura nga drejtoritë arsimore.

10. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave nga viti i dytë e lart, për të gjitha kategoritë e shkollave, të jetë data 15 nëntor 2002.

11. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për arsimin e lartë, viti i parë, të jetë data 30 nëntor 2002.

12. Kuotat financiare të ushqimit në mensa ndryshohen nga Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Financave, në varësi të indeksit të çmimeve të konsumit, por jo më shumë se një herë në vit.

13. Efektet financiare që rrjedhin nga rritja e kuotës së fjetjes, për vitin shkollor 2002-2003, të

përballohen nga Buxheti i Shtetit, miratuar për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.

14. Trajtimi ushqimor i nxënësve bursistë, konviktorë, të përballohet nga fondet buxhetore, të miratuara për Ministrinë e Arsimit dhe të Shkencës.

15. Çdo vendim apo udhëzim në fuqi për bursën, kuotën ushqimore, veshmbathjen dhe shpenzime të tjera për nxënësit dhe studentët, nxënësit e arsimit special dhe jetimët shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

KUSHTET EKONOMIKE TË NXËNËSIT PËR DHËNIEN E BURSËS
PASQYRA NR. 1

në lekë

| Nr. | Përbërja familjare | Të ardhurat për frymë në familjet e nxënësve | | |
|---|---|---|---|---|
| | Për qytetin | Bursa | Gjysmëbursa | Me pagesë |
| 1 | Për familjet me 2 persona | 1550 | 1550-2650 | mbi 2650 |
| 2 | Për familjet me 3 persona | 1350 | 1350-2350 | mbi 2350 |
| 3 | Për familjet me 4 persona | 1250 | 1250-2300 | mbi 2300 |
| 4 | Për familjet me 5 persona | 1150 | 1150-2200 | mbi 2200 |
| 5 | Për familjet me 6 persona | 1050 | 1050-2145 | mbi2145 |
| 6 | Për familjet me 7 persona | 1000 | 1000-2100 | mbi 2100 |
| 7 | Për familjet me mbi 7 persona | 900 | 900-2000 | mbi 2000 |

Shënim: Nxënësit nga fshati përfitojnë bursë të plotë, kur familja fshatare përfiton ndihmë ekonomike të plotë dhe 70 për qind të bursës së plotë, kur familja fshatare përfiton ndihmë ekonomike të pjesshme, të tjerët me pagesë.

KUSHTET EKONOMIKE TË STUDENTIT PËR DHËNIEN E BURSËS
PASQYRA NR. 2

në lekë

| Nr. | Përbërja familjare | Të ardhurat për frymë në familjet e nxënësve | | |
|---|---|---|---|---|
| | Për qytetin | Bursa | Gjysmë bursa | Me pagesë |
| 1. | Për familjet me 2 persona | 1980 | 1980-3190 | mbi 3190 |
| 2. | Për familjet me 3 persona | 1760 | 1760-2860 | mbi 2860 |
| 3. | Për familjet me 4 persona | 1650 | 1650-2800 | mbi 2800 |
| 4. | Për familjet me 5 persona | 1485 | 1485-2750 | mbi 2750 |
| 5. | Për familjet me 6 persona | 1375 | 1375-2673 | mbi 2673 |
| 6. | Për familjet me 7 persona | 1300 | 1300-2596 | mbi 2596 |
| 7. | Për familjet me mbi 7 persona | 254 | 1254-2486 | mbi 2486 |
| | | | | |

Shënim: Studentët nga fshati përfitojnë bursë të plotë kur familja fshatare përfiton ndihmë ekonomike të plotë dhe 70 për qind të bursës së plotë kur familja fshatare përfiton ndihmë ekonomike të pjesshme, të tjerët me pagesë.

NIVELI I BURSËS DHE KUOTËS USHQIMORE PËR STUDENTIN
PASQYRA NR. 3

në lekë

| Nr. | Kategoritë e studentëve sipas shkollave | Bursa | Myra e mbulimit | | Mënyra e shpenzimit | | Fjetja | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | | | Ushqimi | | | |
| | | | Nga buxheti | Nga studenti | Nga buxheti | Nga studenti | Nga buxheti | Nga studenti |
| 1. | Universitetet, Akademia e Arteve dhe Shkolla e lartë e Infermierisë | | | | | | | |
| | Bursa | 7500 | 7500 | | 6500 | | 1000 | |
| | Gjysmë bursa | 7500 | 3750 | 3750 | 3250 | 3250 | 500 | 500 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Me pagesë | | | 7500 | | 6500 | | 1000 |
| 2. | Akademia e Edukimit Fizik | | | | | | | |
| | Bursa | 8100 | 8100 | | 7100 | | 1000 | |
| | Gjysmëbursa | 8100 | 4050 | 4050 | 3550 | 3550 | 500 | 500 |
| | Me pagesë | | | 8100 | | 7100 | | 1000 |

NIVELI I BURSËS DHE I KUOTËS USHQIMORE PËR NXËNËSIT
PASQYRA NR. 4

në lekë

| Nr. | Kategoritë e nxënësve sipas shkollave | Bursa | Mënyra e mbulimit | | Mënyra e shpenzimit | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Nga buxheti | Nga nxënësi | Ushqimi | Shpenzime të vogla |
| 1 | Shkolla 8-vjeçare e të mesme | | | | | |
| | Bursa | 4500 | 4500 | | 4350 | 150 |
| | Gjysmëbursa | 4500 | 2250 | 2250 | 4350 | 150 |
| | Me pagesë | | | 4350 | 4350 | |
| 2 | Shkolla e Mjeshtërisë Sportive | | | | | |
| | Bursa | 4950 | 4950 | | 4800 | 150 |
| | Gjysmëbursë | 4950 | 2475 | 2475 | 4800 | 150 |
| | Me pagesë | | | 4800 | 4800 | |
| 3 | Shkolla e Futbollit | | | | | |
| | Bursa | 5650 | 5650 | | 5500 | 150 |
| | Gjysmëbursë | 5650 | 2825 | 2825 | 5500 | 150 |
| | Me pagesë | | | 5500 | 5500 | |

KUOTAT FINANCIARE TË VESHMBATHJES
PASQYRA NR. 5

në lekë

| Nr | Emërtimi | Kuotat financiare të veshmbathjes për një vit kalendarik |
|---|---|---|
| 1. | Për fëmijët e shtëpisë të moshës parashkollore | 5000 |
| 2. | Për fëmijët e shtëpisë të moshës shkollore dhe të institucioneve të nxënësve që nuk dëgjojnë, nuk flasin dhe nuk shikojnë | 7000 |
| 3. | Për jetimët e shkollave të mesme dhe të larta | 10000 |

Niveli i bursës dhe i kuotës ushqimore për nxënësin e arsimit special
Pasqyra nr. 5/1

në lekë

| Nr. | Kategoritë e nxënësve sipas shkollave | Bursa | Mënyra e mbulimit | | Mënyra e shpenzimit | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | | | Nga buxheti | Nga nxënësi | Ushqimi | Shpenzime të vogla |
| | | | | | | |
| 1. | Nxënësit jetim dhe të institucioneve speciale | 5300 | 5300 | | 5150 | 150 |

Kuota ushqimore ditore për nxënësin dhe studentin
Pasqyra nr. 6

në lekë

| | |
|---|---|
| 1. Universitete, Akademia e Arteve dhe Shkolla e Lartë e Infermierisë | 216.6 lekë në ditë |
| 2. Studentë të ILKF "Vojo Kushi" | 236.6 lekë në ditë |
| 3. Nxënës të shkollave tetëvjeçare dhe të mesme | 145 lekë në ditë |

KUOTA FINANCIARE SIPAS NORMAVE NË NATYRË PËR USHQIM TË STUDENTËVE
PASQYRA NR. 7

| Nr | Emërtimi | Njësia matjes | Norma mes.ditore | Çmimi mesatar | Vlera |
|---|---|---|---|---|---|
| 1. | Bukë | gram | 600 | 66 | 39.6 |
| 2. | Makarona | gram | 30 | 88 | 2.64 |
| 3. | Oriz | gram | 30 | 88 | 2.64 |

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| 4. | Sheqer | gram | 55 | 85 | 4.68 |
| 5. | Fasule | gram | 35 | 144 | 5.04 |
| 6. | Patate | gram | 200 | 60 | 12 |
| 7. | Perime | gram | 300 | 75 | 22.6 |
| 8. | Fruta | gram | 100 | 100 | 10 |
| 9. | Vaj | gram | 30 | 190 | 5.7 |
| 10. | Gjalp | gram | 15 | 520 | 7.8 |
| 11. | Mish | gram | 100 | 600 | 60 |
| 12. | Qumësht | gram | 200 | 40 | 8 |
| 13. | Djath | gram | 40 | 350 | 14 |
| 14. | Reçel | gram | 40 | 250 | 10 |
| 15. | Vezë | kokrra | 1 | 10 | 10 |
| 16. | Çaj, erëza etj. | gram | | | 1.9 |
| | Kuota ditore | | | | 216.6 |

**V E N D I M**
**Nr. 542, datë 31.10.2002**

**PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË AGJENCISË SË NXITJES SË INVESTIMEVE TË HUAJA (ANIH)**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 1 pika 2 e 9 të ligjit nr. 8877, datë 4.4.2002 "Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja", me propozimin e Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e statutit të Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja (ANIH), që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

Statuti i Agjencisë së nxitjes së investimeve të huaja (ANIH)

Dispozita të përgjithshme

Neni 1
**Vlera ligjore e statutit**

Statuti është dokumenti bazë, që rregullon veprimtarinë e kësaj agjencie, brenda dhe jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, krijimi i së cilës është parashikuar në ligjin nr. 8877, datë 4.4.2002 "Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja".

Neni 2
**Statusi juridik i agjencisë**

Agjencia është person juridik, publik, që nuk ushtron veprimtari fitimprurëse. Nëse ndonjë veprimtari e saj mund të gjenerojë të ardhura, ato duhet të kontabilizohen në zërat përkatëse të fondeve të agjencisë dhe të përdoren vetëm për qëllimin për të cilin është krijuar agjencia.

Neni 3
**Emërtimi i shkurtuar**

Emërtimi i shkurtuar i agjencisë është ANIH. Selia e saj ndodhet në Tiranë, në adresën Bulevardi "Zhan d'Ark", pallatet e Lanës.

Neni 4
**Stema dhe vula**

Stema e agjencisë shpreh thelbin e veprimtarisë së saj, që është tërheqja e investimeve të huaja dhe duhet të figurojë në të gjithë materialet prezantuese dhe shkresat zyrtare të agjencisë.

Përmbajtja e vulës së agjencisë është: "Republika e Shqipërisë, Agjencia e Nxitjes së Investimeve të Huaja (ANIH)".

Objekti i veprimtarisë së Agjencisë

Neni 5
**Ligjshmëria e veprimtarisë**

Agjencia vepron në mbështetje të dispozitave të Kodit Civil, përcakton mundësitë për investime, nxit dhe mbështet investitorët ekzistues dhe të rinj për të investuar në Shqipëri.

Neni 6
**Objekti**

Agjencia ka objekt të veprimtarisë:

- mbajtjen e lidhjeve me të gjitha ministritë, agjencitë publike, institucionet financiare, dhomat e tregtisë, shoqatat e biznesit dhe të investitorëve dhe me organizata të tjera, të interesuara për të bashkërenduar veprimtaritë që u shërbejnë investitorëve;
- dhënien e ndihmës në zbatimin e politikave të qeverisë për investimet e huaja dhe të politikës së privatizimit;
- dhënien e rekomandimeve të nevojshme për përmirësimin e legjislacionit për të krijuar një klimë të favorshme për investitorët, sidomos ata të huaj;
- dhënien e këshillave investitorëve të huaj dhe lehtësimin e krijimit të lidhjeve të tyre me biznesin vendas, si në fazën fillestare e gjatë kryerjes së investimeve, edhe pas përfundimit të tyre. Gjithashtu, ajo ndihmon shoqëritë e huaja ekzistuese për kapërcimin e barrierave, që frenojnë zhvillimin e biznesit dhe ndihmon shoqëritë vendase për të gjetur partnerë të huaj, për të krijuar lidhje sa më të qëndrueshme me ta;
- mbledhjen, përpunimin, ndërtimin dhe zhvillimin e sistemit të të dhënave për investimet, si dhe shpërndarjen dhe shkëmbimin e këtyre të dhënave me rrjetin e subjekteve të interesuara, brenda dhe jashtë vendit;
- dhënien e ndihmesës në promovimin e kulturës së biznesit në të gjithë sektorët e ekonomisë së vendit;
- zhvillimin e veprimtarive nxitëse, brenda dhe jashtë vendit, për një imazh të Shqipërisë, si një vend tërheqës për investime dhe pasqyrimin e potencialeve në prodhimin e mallrave, shërbimeve, lëndëve të para me leverdi në konkurrencën e lirë;
- kryerjen e veprimtarive studimore, në përputhje me funksionet e saj, duke përfshirë studime fizibiliteti, studime tregu, anketime, konsulencë në praktikat tregtare të menaxhimit dhe të veprimtarive nxitëse.

Burimet e financimit

Neni 7
**Burimet bazë të financimit**

Në përputhje me nenin 8 të ligjit nr. 8877, datë 4.4.2002 "Për krijimin e Agjencisë së Nxitjes së Investimeve të Huaja", burimi kryesor i financimit të agjencisë vjen nga Buxheti i Shtetit.

Agjencia harton projektbuxhetin, sipas rregullave, metodikave dhe afateve të përcaktuara në ligjin nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë" dhe të akteve nënligjore në zbatim të tij.

Agjencia mund të sigurojë fonde shtesë edhe nga donatorë të ndryshëm.

Neni 8

**Përdorimi i fondeve**

Agjencia gëzon të drejtën e depozitimit dhe të përdorimit të mjeteve të veta financiare sipas vendimeve të Këshillit Mbikëqyrës.

Agjencia nuk mund të kryejë asnjë veprimtari tjetër jashtë objektivave dhe programit të përcaktuar në statut.

Fondet financiare nuk mund të përdoren, në mënyrë të drejtëpërdrejtë e as të tërthortë, për qëllime të tjera.

Burimet e ndryshme financiare agjencia i përdor vetëm për kryerjen e veprimtarive në përputhje me objektin e vet.

Agjencia krijon dhe menaxhon fondet e mëposhtme:

- fondin themelor;
- fondin e mjeteve të xhiros;
- fondin rezervë, në lekë;
- fondin rezervë në valutë;
- fonde të tjera, sipas vendimeve të përcaktuara nga Këshilli Mbikëqyrës.

Neni 9

**Qëndrimi ndaj donacioneve**

Donacionet pranohen ose kundërshtohen me vendim të Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë, në përputhje me aktet, ligjore e nënligjore, në fuqi. Në rast kundërshtimi, në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës të Agjencisë shënohen edhe arsyet e këtij kundërshtimi.

Donatorët e huaj ose vendas, që kontribuojnë me fonde financiare, me një vlerë më të madhe se 50 për qind e fondeve vjetore të Buxhetit të Shtetit për agjencinë kanë të drejtë të caktojnë një këshilltar pranë drejtorit ekzekutiv të agjencisë. Drejtori ekzekutiv është i detyruar të këshillohet me këshilltarin për të gjitha çështjet që kanë të bëjnë me përdorimin e fondeve të dhëna nga ai.

Struktura organizative e agjencisë

Neni 10

**Organet drejtuese**

Organet drejtuese janë:

1. Këshilli Mbikëqyrës,
2. drejtori ekzekutiv.

Këshilli mbikëqyrës

Neni 11

**Përbërja**

Përbërja e Këshillit Mbikëqyrës përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Ministri i Ekonomisë është Kryetar i Këshillit Mbikëqyrës. Përfaqësuesit e komunitetit të biznesit propozohen nga shoqatat e biznesit dhe duhet të plotësojnë kriteret e përcaktuara në udhëzimin nr. 115, datë 6.8.2002 të Ministrit të Ekonomisë. Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës janë përfaqësues të komunitetit të biznesit dhe emërohen nga Ministri i Ekonomisë për një periudhë dyvjeçare me sistem rotacioni.

Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës njofton Këshillin e Ministrave për problemet e rëndësishme lidhur me investimet e huaja.

Neni 12
**Mandati i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës**

Mandati i anëtarit të Këshillit Mbikëqyrës përfundon me:

a) mbarimin e afatit të përcaktuar në nenin 11 të statutit, si dhe në rastet kur:

b) jep dorëheqjen;

c) shkarkohet nga detyra për veprime ose mosveprime, që dëmtojnë rëndë interesat e agjencisë;

ç) mungon brenda 1 viti, pa arsye, në 4 mbledhje dhe me arsye në 6 mbledhje.

Kërkesa për dorëheqje i bëhet me shkrim Kryetarit të Këshillit Mbikëqyrës, i cili duhet ta miratojë atë brenda 5 (pesë) ditëve.

Neni 13
**Detyrat e Këshillit Mbikëqyrës**

Këshilli Mbikëqyrës ka këto detyra:

- Harton statutin e agjencisë dhe i propozon Këshillit të Ministrave ndryshime, kur e sheh të nevojshme.
- Miraton programin e veprimtarisë për vitin financiar, i cili paraqitet nga drejtori ekzekutiv.
- Miraton strukturën organizative dhe buxhetin.
- Miraton rregulloren e brendshme për funksionimin.
- Emëron dhe liron nga detyra drejtorin ekzekutiv.
- Miraton bilancin e veprimtarisë ekonomiko-financiare, në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- Mbikëqyr, në vazhdimësi, përmbushjen e detyrave.

Neni 14
**Mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës**

Këshilli Mbikëqyrës mblidhet periodikisht, jo më pak se 6 herë në vit, me thirrjen e kryetarit të Këshillit. Anëtarët lajmërohen, me shkrim, 15 ditë para zhvillimit të mbledhjes. Kur është e nevojshme, njoftimit i bashkëlidhen edhe projektvendimet që parashikohen të shqyrtohen në mbledhje.

Në raste të veçanta, mbledhja e Këshillit Mbikëqyrës thirret nga drejtori ekzekutiv ose nga të paktën tre anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës.

Mbledhja drejtohet nga Kryetari i Këshillit Mbikëqyrës dhe, në mungesë të tij, nga anëtari më i moshuar.

Neni 15
**Vlefshmëria e mbledhjeve**

Këshilli Mbikëqyrës nuk mund të marrë vendime të vlefshme pa qenë të pranishëm gjysma e numrit të anëtarëve plus 1. Kur ky numër nuk arrihet mbledhja shtyhet edhe për 24 orë.

Vendimet merren me shumicë të thjeshtë votash të anëtarëve të pranishëm. Votimi është i hapur, përveç rasteve të veçanta të parashikuara me ligj. Votimi mund të kryhet edhe me anë të shkëmbimit të dokumentacionit të shkruar, sipas rregullave të konsultimit me shkrim. Në rast rezultati të barabartë votash, vota e kryetarit është përcaktuese.

Neni 16
**Pjesëmarrja në mbledhje e personave të tjerë**

Në mbledhjet e Këshillit Mbikëqyrës kryetari fton këshilltarë ose dhe ekspertë të jashtëm, kur këtë e kërkojnë rrethanat.

Drejtori ekzekutiv, këshilltarët dhe ekspertët e ftuar marrin pjesë në mbledhje pa të drejtë vote.

Neni 17
**Konflikti i interesave**

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës detyrohen të deklarojnë pozicionin e tyre në Këshillin Mbikëqyrës, kur çështje të rendit të ditës dhe vendime të Këshillit Mbikëqyrës lidhen drejtpërdrejt me interesat e tyre të biznesit. Në këto raste, ata nuk marrin pjesë në diskutime dhe as në votim.

Neni 18
Shpërblimi

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës gëzojnë të drejtën e shpërblimit për pjesëmarrje në mbledhjet e Këshillit, sipas vendimit nr. 334, datë 11.7.2002 të Këshillit të Ministrave dhe të rimbursimit të shpenzimeve për shërbime, udhëtime e dieta, që lidhen me veprimtarinë e tyre për zbatimin e programit të agjencisë.

DREJTORI EKZEKUTIV I AGJENCISË

Neni 19
**Mandanti i drejtorit ekzekutiv**

Drejtori ekzekutiv emërohet nga Këshilli Mbikëqyrës, në mbledhjen e parë të tij për një afat trevjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje edhe për tre vjet të tjera. Zgjedhja e tij bëhet me konkurs, ku të paktën të jenë tre konkurrues. Data e konkursit botohet në organet e shtypit.

Neni 20
**E drejta e përfaqësimit**

Agjencia, në marrëdhënie me të tretët, përfaqësohet nga drejtori ekzekutiv dhe, në mungesë të tij, nga zëvendësdrejtori. Zëvendësdrejtori emërohet nga drejtori ekzekutiv, për një mandat trevjeçar.

Neni 21
**Të drejtat dhe detyrat e drejtorit ekzekutiv**

Drejtori ekzekutiv ka këto të drejta dhe detyra:

- Drejton dhe administron veprimtarinë e agjencisë dhe përgjigjet para Këshillit Mbikëqyrës.
- Harton rregulloren e brendshme të agjencisë dhe ia paraqet për miratim Këshillit Mbikëqyrës.
- Në funksion të përmbushjes së programit të punës, i paraqet Këshillit Mbikëqyrës, para fillimit të një veprimtarie, buxhetin dhe programin e realizimit të saj.
- Harton dhe i paraqet për miratim Këshillit Mbikëqyrës bilancin e agjencisë.
- Përgjigjet për shpenzimet e bëra nga buxheti, në përputhje me objektivat, qëllimin e funksionimit të agjencisë.
- Raporton të paktën 4 herë në vit para Këshillit Mbikëqyrës për veprimtarinë e agjencisë.
- Harton dhe zbaton procedurat e punësimit të personelit, me metodën e konkurrimit, të shpallur publikisht, për çdo vend pune.
- Bashkërendon punën me Këshillin Mbikëqyrës për të zhvilluar dhe administruar strategjinë e qeverisë për nxitjen e investimeve.
- Përgjigjet për të gjitha veprimtaritë e agjencisë që i shërbejnë përmirësimit të imazhit të Shqipërisë.
- Bashkëpunon me donatorë, vendas dhe të huaj, për sigurimin e fondeve.
- Krijon, zhvillon dhe ruan lidhje të vazhdueshme institucionale me përfaqësues të organizatave të biznesit dhe të institucioneve publike.
- Garanton cilësinë e materialeve, informuese e promovuese dhe shpërndarjen e tyre në kohë.

Neni 22
**Mbarimi i mandatit**

Drejtori ekzekutiv lirohet nga detyra në rastet kur:
a) i mbaron mandati dhe nuk riemërohet;
b) mbush moshën e pensionit;
c) emërohet në një detyrë tjetër, të papajtueshme me atë të drejtorit ekzekutiv.
Drejtori ekzekutiv lirohet nga detyra edhe para mbarimit të mandatit kur:
a) vërehet se agjencia mbingarkohet me borxhe për shkak të drejtimit të tij;
b) shpallet fajtor me vendim të gjykatës së formës së prerë për kryerjen e një vepre penale;
c) vepron në kundërshtim me programin dhe objektivat e miratuara nga Këshilli Mbikëqyrës.
Zëvendësdrejtori shkarkohet nga detyra me urdhër të drejtorit ekzekutiv, por pas miratimit nga kryetari i Këshillit Mbikëqyrës.
Marrëdhëniet e punës

Neni 23
**Struktura e organika e agjencisë dhe pagat**

Struktura e organika e agjencisë dhe niveli i pagave përcaktohen e miratohen me vendim të Këshillit Mbikëqyrës, në përputhje me nivelin e pagave në institucionet e administratës qendrore.

Neni 24
**Rregullat e punësimit**

Kriteret e marrjes në punë dhe përshkrimi i vendeve të punës përcaktohen nga Këshilli Mbikëqyrës. Lidhja e kontratave të punës bëhet nga drejtori ekzekutiv.

Neni 25
**Viti financiar**

Viti financiar i agjencisë fillon më 1 janar dhe mbaron më 31 dhjetor të atij viti. Për çdo vit financiar hartohet bilanci ekonomiko-financiar, konform dispozitave ligjore në fuqi. Brenda datës 30 prill të çdo viti, drejtori ekzekutiv i paraqet Këshillit Mbikëqyrës, për shqyrtim e miratim, bilancin e vitit financiar pararendës.

Neni 26
**Kontrolli**

Këshilli Mbikëqyrës cakton ekspertë ose ekspertë kontabël, të autorizuar sipas ligjeve në fuqi për ushtrimin e kontrollit të veprimtarisë ekonomiko-financiare të agjencisë.

Neni 27
**Dispozita të fundit**

Çështje të veçanta të veprimtarisë së agjencisë, që nuk parashikohen në këtë statut, do të përfshihen në rregulloren e brendshme të agjencisë.

Neni 28
**Hyrja në fuqi**

Ky statut hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**V E N D I M**
**Nr. 543, datë 31.10.2002**

**PËR AKREDITIMIN E INSTITUCIONEVE TË ARSIMIT DHE FORMIMIT PROFESIONAL (AFP)**

Në mbështetje të pikës 3 të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 9 të ligjit nr. 8872, datë 29.3.2002 "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës dhe të Ministrit të Punës dhe të Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Ministria e Arsimit dhe e Shkencës dhe Ministria e Punës dhe e Çështjeve Sociale të krijojnë Komisionin e Akreditimit të institucioneve të arsimit dhe formimit profesional, përbërja, organizimi dhe funksionet e të cilit të përcaktohen me udhëzimin e përbashkët të të dy ministrave.

2. Komisioni vendos për akreditimin ose jo të institucioneve të AFP-së brenda një periudhe tremujore nga data e paraqitjes së kërkesës për akreditim, së bashku me dokumentacionin e nevojshëm.

3. Kriteret e përgjithshme për dhënien ose jo të akreditimit janë:

a) Ligjshmëria e institucionit të AFP-së:

- dokumenti i regjistrimit si institucion i AFP-së;
- dokumenti ligjor që i jep të drejtë institucionit të përdorë truallin, ndërtesën dhe mjediset e tjera ndihmëse.

b) Menaxhimi i institucionit të AFP-së:

- struktura organizative e institucionit të AFP-së;
- përshkrimi i funksioneve për çdo njësi organizative;
- përshkrimi i punës për çdo anëtar të personelit;
- dokumenti i planifikimit të veprimtarisë së institucionit;
- rregullorja e funksionimit të brendshëm të institucionit;
- rregullorja financiare e institucionit.

c) Përshkrimi i arsimim/formimit profesional që ofron institucioni i AFP-së:

- lista e specialiteteve të arsimit dhe formimit profesional që ofron institucioni;
- programi i përgjithshëm (skeletkurrikula) për secilin arsim/formim;
- programet e lëndëve/ moduleve për secilin arsim/formim;
- përshkrimi i nivelit të pritshën të arritjeve të nxënësve në fund të arsim/formimit;
- llojin e dokumentit që lëshon në përfundim të arsimit/formimit.

ç) Personeli i institucionit të AFP-së:

- niveli dhe specialiteti i arsimimit, përvoja dhe kualifikimet e personelit drejtues dhe atij ndihmës;
- niveli dhe specialiteti i arsimimit, përvoja dhe kualifikimet e personelit mësimdhënës;
- numri i personelit, me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme;
- struktura e pagave të personelit;
- marrëveshja me sigurimet shoqërore;
- kontratat e punës së personelit;

d) Infrastruktura e institucionit të AFP-së:

- mjediset, orenditë dhe pajisjet në funksion të personelit drejtues dhe atij ndihmës;
- mjediset, orenditë, pajisjet dhe materialet didaktike, në funksion të procesit mësimor, teorik e praktik;
- numri i nxënësve/kursantëve, në raport me mjediset mësimore;
- hapësirat e mjediseve mësimore;
- ndriçimi i mjediseve mësimore;
- masat e sigurisë dhe të ruajtjes së mjedisit;
- kushtet higjieno-sanitare.

4. Komisioni i Akreditimit angazhon grupe ekspertësh për hartimin e manualit të akreditimit të

institucioneve të AFP-së, i cili përmban kriteret e akreditimit, të hollësishme nga pikpamja sasiore e cilësore.

5. Manuali i akreditimit të institucioneve të AFP-së miratohet nga Komisioni i Akreditimit.

6. Komisioni i Akreditimit mund të ngarkojë ekspertë/grupe ekspertësh për të bërë vlerësimin e institucioneve të AFP-së, që aplikojnë për akreditim.

7. Shpërblimi i anëtarëve të Komisionit të Akreditimit dhe të ekspertëve të jashtëm bëhet në përputhje me legjislacionin në fuqi.

8. Akreditimi jepet për një periudhë trevjeçare, me të drejtë ripërtëritje.

9. Akreditimi hiqet kur shkelen kriteret e përcaktuara. Të drejtën për heqjen e akreditimit e ka komisioni i akreditimit.

10. Tarifa për akreditimin është 10 000 lekë.

11.Vendimi nr.354, datë 12.5.1996 i Këshillit të Ministrave "Për autorizimin dhe mbikëqyrjen e qendrave, publike e private, të formimit profesional" shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

**V E N D I M**
**Nr. 544, datë 7.11.2002**

**PËR DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN "PRODUKTET E MBROJTJES SË BIMËVE", MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 72, DATË 15.2.2001 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 50 të ligjit nr. 7662, datë 19.1.1993 "Për shërbimin e mbrojtjes së bimëve", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në rregulloren "Produktet e mbrojtjes së bimëve", miratuar me vendimin nr. 72, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave, të bëhen këto ndryshime:

1. Në nenin 13 të rregullores:

a) shkronja "b" pika 1 ndryshon si më poshtë vijon:

"b. Lënda aktive është e regjistruar në njërin nga shtetet anëtare të KE-së, SHBA-së, Japonisë, Kanadasë.".

b) Pika 3 ndryshon si më poshtë vijon:

"3. KSHRPMB-ja i propozon Ministrit ndryshimin ose anulimin e një vendimi të regjistrimit, në përputhje me vendimet e mëtejshme të Komunitetit Europian për këtë lëndë aktive.".

2. Në nenin 72, pika 2 ndryshon si më poshtë vijon:

"2. Vlera e shpenzimeve administrative është:

a) Për PMB-të, lënda aktive e cila është e përfshirë

në aneksin 1 të direktivës 91/414 EEC,150 000 lekë;b) Për PMB-të me lëndë aktive të re150 000 lekë;

c) Për PMB-të me lëndë aktive të vjetër100 000 lekë;

ç) Për PMB-të e njëjta me ato të regjistruarat 50 000 lekë;

d) Për përsëritjen e regjistrimit 100 000 lekë;

dh)Për autorizimin e përkohshëm të PMB-së 50 000 lekë;

e) Për ndryshimet në etiketën e PMB-ve 30 000 lekë;

ë) Për ndryshimin e mbajtësit të dokumentit të regjistrimit

të PMB-së 30 000 lekë;

20 për qind e vlerës së shpenzimeve të mësipërme paguhet nga aplikanti menjëherë me depozitimin e kërkesës për shërbimet administrative, të përmendura në këtë pikë, ndërsa pjesa tjetër pas kryerjes së shërbimit.".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

**V E N D I M**
**Nr. 549, datë 7.11.2002**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 277, DATË 18.6.1997 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR PËRFITIMET NGA STATUSI I TË VERBËRIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të ligjit nr. 8098, datë 28.3.1996 "Për statusin e të verbërit", me propozimin e Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Në pikën 12 të vendimit nr. 277, datë 18.6.1997 të Këshillit të Ministrave fjalët "këshillat e rretheve" zëvendësohen me "këshillat e qarqeve".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

**V E N D I M**
**Nr. 551, datë 7.11.2002**

**PËR KLASIFIKIMIN E FUNKSIONEVE DHE GRUPIMIN E NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE, PËR EFEKT PAGE, E PËR CAKTIMIN E KUFIJVE TË PAGAVE TË PUNONJËSVE TË ORGANEVE TË QEVERISJES VENDORE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 5 të ligjit nr. 8487, datë 13.5.1999 "Për kompetencat e caktimit të pagave të punës", ndryshuar me ligjin nr. 8935, datë 12.9.2002 dhe të neneve 32 e 54 të ligjit nr. 8652, datë 31.7.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", me propozimin e Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale dhe të Ministrit të Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Struktura e pagave dhe nivelet për nëpunësit civilë në Bashkinë e Tiranës të jenë sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Struktura e pagave dhe nivelet për nëpunësit civilë në bashkitë e tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe për nëpunësit e komunave sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

3. Struktura dhe nivelet e pagave për nëpunësit civilë në këshillin e qarkut të jenë sipas lidhjes nr.3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

4. Paga e grupit, (kolona 2) - diploma e shkollës së lartë të jetë 9000 lekë.

5. Shtesa për vjetërsi në punë (kolona 3) të jepet në masën 2 për qind pas çdo viti pune, deri në 25 vjet, dhe të llogaritet mbi pagën e grupit.

6. Shtesa për kualifikim (kolona 4) të jetë 0.

7. Shtesa për pozicion për Bashkinë e Tiranës dhe këshillin e qarkut të jetë sipas kolonës 5, ndërsa për bashkitë e tjera, komunat dhe njësitë bashkiake të Tiranës të jetë sipas kolonave 5, 6, 7 e 8 të lidhjeve nr.1, 2 dhe 3.

8. Kategorizimi (kolona 1) brenda çdo klase bëhet në përputhje me lidhjen nr. 4, që i

bashkëlidhet këtij vendimi.

9. Nivelet e pagave për funksionet e mëposhtme të jenë:

a) Për Bashkinë e Tiranës:

- Kryetari104 500 -150 000 lekë;
- Nënkryetari 69 500 – 117 000 lekë.

b) Për njësitë e qeverisjes vendore, me më tepër se 50 000 banorë:

- kryetari49 660 -100 000 lekë;
- nënkryetari21 000 – 75 000 lekë.

c) Për njësitë e qeverisjes vendore, me 20 001- 50 000 banorë:

- kryetari33 980 -80 000 lekë;
- nënkryetari20 000 – 65 000 lekë.

ç) Për njësitë e qeverisjes vendore, me 5 001 - 20 000 banorë:

- kryetari21 000 –65 000 lekë;
- nënkryetari17 000 – 55 000 lekë.

Për njësitë e qeverisjes vendore, me më pak se 5 000 banorë:

- kryetari17 000 - 40 000 lekë;
- nënkryetari16 000 – 30 000 lekë.

dh) Për këshillin e qarkut:

- kryetari69 500 -110 000 lekë;
- nënkryetari40 500 – 75 000 lekë.

Për funksionin e sekretarit:

- Sekretari i Kryetarit të Bashkisë së TiranësKategoria IV-a (lidhja nr.1);
- sekretari i kryetarit të bashkive të tjeraKategoria IV-b (lidhja nr.2);
- Sekretari i Kryetarit të Këshillit të Qarkut të Tiranës Kategoria IV-b (lidhja nr.3);

10. Nivelet e pagave për funksionet e mëposhtme të jenë:

- Shefi i Kabinetit në Bashkinë e Tiranës dhe Sekretari i Këshillit Bashkiak të Tiranës: kategoria II-a (lidhja nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi);

- Këshilltari i Kryetarit të Bashkisë së Tiranës dhe zëdhënësi: kategoria II-b (lidhja nr. 1 që i bashkëlidhet këtij vendimi);

- Shefi i Kabinetit dhe Sekretari i Këshillit të Qarkut: kategoria I-b (lidhja nr.3 që i bashkëlidhet këtij vendimi).

- Këshilltari i Kryetarit të Këshillit të Qarkut dhe zëdhënësi: kategoria II-b (lidhja nr.3 që i bashkëlidhet këtij vendimi).

- Shefi i kabinetit dhe sekretari i këshillit bashkiak të bashkive të tjera, të njësive bashkiake të Tiranës dhe të komunave: kategoria I-b (lidhja nr. 2 që i bashkëlidhet këtij vendimi).

- Këshilltari i kryetarit të bashkisë dhe zëdhënësi i bashkive të tjera, i njësive bashkiake të Tiranës dhe i komunave: kategoria II-b (lidhja nr.2 që i bashkëlidhet këtij vendimi).

11. Këshilli i qarkut, këshilli bashkiak, këshilli i komunës miratojnë pagën për secilin funksion, të zgjedhur apo të emëruar, brenda kufijve të pagave të përcaktuara, përkatësisht në lidhjet nr.1, 2 e 3, që i bashkëlidhen këtij vendimi, si dhe në pikën 10 të këtij vendimi. Këshilli Bashkiak i Tiranës miraton pagën për funksionet, e zgjedhura apo të emëruara, të njësive bashkiake të Tiranës. Për caktimin e pagës, këshillat përkatëse mbështeten në burimet financiare të buxhetit të tyre vjetor.

Për këtë ata bëjnë rritje graduale të pagës në raport me rritjen e burimeve të brendshme financiare dhe përmirësimin e strukturës së administratës, por pa prekur nivelin e shpenzimeve për shërbimet publike të vitit pararendës.

12. Këshillat e njësive të qeverisjes vendore, kur është e nevojshme, krijojnë funksione të reja, të cilat nuk janë të përcaktuara në lidhjet, që i bashkëlidhen këtij vendimi, bëjnë njehsimin e tyre, për efekt page, me klasifikimin e miratuar.

13. Këshillat e njësive të qeverisjes vendore miratojnë shpërblimin mujor të këshilltarëve dhe kryetarëve të fshatrave në masën deri në 10 për qind të pagës, përkatësisht, të kryetarit të këshillit të qarkut, kryetarit të bashkisë, kryetarit të njësisë bashkiake dhe atij të komunës.

14. Këshillat e njësive të qeverisjes vendore miratojnë pagën e punonjësve të njësive ekonomike dhe të institucioneve të varësisë, me përjashtim të rasteve kur me ligj është parashikuar ndryshe.

15. Paga e punonjësve që kanë funksione në shërbimin civil, por që nuk kanë arsimin e lartë,

caktohet nga këshilli përkatës në kufirin maksimal deri në 25 000 (njëzet e pesë mijë) lekë.

16. Paga e punonjësve të tjerë (që nuk janë nëpunës civilë) të njësive të qeverisjes vendore caktohet nga këshilli përkatës, në kufirin maksimal deri në 20 000 (njëzet mijë) lekë.

17. Vendimi nr. 219, datë 13.4.2001 i Këshillit të Ministrave "Për shpërblimin e anëtarëve të këshillit të qarkut, të bashkisë, të njësive bashkiake të Tiranës, të komunave dhe të kryetarëve të fshatrave" shfuqizohet.

18. Vendimi nr. 726, datë 21.12.2000 i Këshillit të Ministrave "Për pagat e punonjësve të institucioneve buxhetore", ndryshuar me vendimet përkatëse, si dhe çdo akt tjetër nënligjor, për punonjësit e organeve të qeverisjes vendore, që bie në kundërshtim me këtë vendim shfuqizohen.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 janar 2003.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

LIDHJA NR.1
NIVELET E PAGAVE PËR PUNONJËSIT CIVILË NË BASHKINË E TIRANËS

| | | Paga mujore (lekë) | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Klasa | Kategoria | Paga individuale | | | Shtesa e pozicionit |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| | | Paga e grupit | Shtesa për vjetërsi | Shtesa për kualifikim | Shtesa për pozicion |
| I | I – b | 9000 | 2% | 0 | Nga 49 800<br>deri në 100 000 |
| II | II – a | 9000 | 2% | 0 | Nga 49 800<br>Deri në 90 000 |
| | II – b | 9000 | 2% | 0 | Nga 40 660<br>Deri në 74 000 |
| III | III – a | 9000 | 2% | 0 | Nga 13 000<br>Deri në 55 000 |
| | III – b | 9000 | 2% | 0 | Nga 12 000<br>Deri në 40 000 |
| IV | IV – a | 9000 | 2% | 0 | Nga 7000<br>Deri në 30 000 |
| | IV – b | 9000 | 2% | 0 | Nga 7 000<br>Deri në 20 000 |

LIDHJA NR.2
NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË BASHKITË E TJERA, NJËSITË BASHKIAKE TË TIRANËS DHE NËPUNËSIT E KOMUNAVE

| | | | | | Paga mujore (lekë) | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Klasa | Kategoritë | Paga individuale | | | Shtesa e pozicionit sipas ndarjes së njësive vendore | | | |
| | | | | | Njësi të qeverisjes vendore me mbi 50001 banorë | Njësi të qeverisjes vendore me 20001- 50000 banorë | Njësi të qeverisjes vendore me 5001 – 20000 banorë | Njësi të qeverisjes vendore me më pak se 5000 banorë |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 |
| | | Paga e grupit | Shtesa për vjetërsi | Shtesa për kualifikim | Shtesa për pozicion | Shtesa për pozicion | Shtesa për pozicion | Shtesa për pozicion |
| I | I – b | 9000 | 2% | 0 | Nga 12000 deri 41000 | Nga 11000 deri 31000 | Nga 8000 deri 21000 | Nga 6000 deri 17000 |
| II | II – a | - | - | - | - | - | - | - |
| | II – b | 9000 | 2% | 0 | Nga 9000 deri 31000 | Nga 9000 deri 26000 | Nga 6000 deri 20000 | - |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| III | III – a | - | - | - | - | - | | - |
| | III – b | 9000 | 2% | 0 | Nga 9000 deri 26000 | Nga 9000 dri 21000 | Nga 6000 deri 16000 | Nga 5000 deri 13000 |
| IV | IV – a | 9000 | 2% | 0 | Nga 3000 deri 16000 | Nga 3000 deri 16000 | Nga 2000 deri 14000 | Nga 2000 deri 11000 |
| | IV – b | 9000 | 2% | 0 | Nga 3000 deri 13000 | Nga 3000 deri 11000 | - | - |

Shënim: Këshilli i bashkisë dhe komunës, në përcaktimin e shtesës në pagë për pozicionin sipas ndarjes në njësi vendore, bazohet në numrin e banorëve të regjistrit të gjendjes civile në fillim të vitit kalendarik.

LIDHJA NR.3
NIVELET E PAGAVE PËR NËPUNËSIT CIVILË NË KËSHILLIN E QARKUT

| | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|
| Klasa | Kategoritë | Paga individuale | | | Shtesa e pozicionit |
| | 1 | 2 | 3 | 4 | 5 |
| | | Paga e grupit | Shtesa për vjetërsi | Shtesa për kualifikim | Shtesa për pozicion |
| I | I – b | 9000 | 2% | 0 | Nga 25000 deri 51000 |
| II | II – a | - | - | - | - |
| | II – b | 9000 | 2% | 0 | Nga 11000 deri 36000 |
| III | III – a | - | - | - | - |
| | III – b | 9000 | 2% | 0 | Nga 9000 deri 26000 |
| IV | IV – a | 9000 | 2% | 0 | Nga 3000 deri 18000 |
| | IV – b | 9000 | 2% | 0 | Nga 3000 deri 13000 |

LIDHJA 4
KLASIFIKIMI I VENDEVE TË PUNËS NË SHËRBIMIN CIVIL PËR ORGANET E QEVERISJES VENDORE

Vendet e punës në Shërbimin Civil grupohen në 4 klasa si më poshtë:

Klasa I: Ka përgjegjësinë për menaxhimin e institucionit, përcaktimin e programeve të përgjithshme në fushat që mbulon institucioni, koordinimin e këtyre programeve të përgjithshme dhe përdorimin eficent të të gjitha burimeve financiare, njerëzore etj., për arritjen e rezultateve të përcaktuara, si dhe dhënien e këshillimit përfundimtar dhe të drejtpërdrejtë drejtuesit të institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

I – b. Sekretar i Përgjithshëm

Drejtor Departamenti

Klasa II: Është niveli më i lartë i menaxhimit të një institucioni dhe ka përgjegjësi për hartimin e programeve në fushën që mbulon dhe për arritjen e rezultateve të përcaktuara në këtë fushë.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

II – a. Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme

Drejtor Drejtorie

Klasa III: Bën të mundur koordinimin e mendimeve dhe opsioneve të reja programore për një fushë të caktuar të specialitetit, zbatimin e programeve në këtë nivel, përgatitjen e propozimeve përfundimtare të cilat duhen aprovuar nga niveli menaxhues më i lartë. Kjo klasë bën të mundur gjithashtu edhe zgjidhjn e problemeve komplekse që lidhen me menaxhimin e projekteve të mëdha ose sektorëve/njësive brenda institucionit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:

III - a Përgjegjës Sektori

Kryeinspektor

III - b Përgjegjës sektori

Specialist i nivelit të lartë
Inspektor

Klasa e IV: Kjo klasë merret me zbatimin e programeve ekzistuese, koordinimin e aktiviteteve të stafit mbështetës, si dhe me formulimin dhe vlerësimin e opsioneve mbi një fushë të caktuar, duke u bazuar në ekspertizën profesionale të fushës, njohuritë e specialitetit, analizën e informacionit dhe kërkimit.

Në këtë klasë bëjnë pjesë kategoritë:
IV - a Specialist i nivelit të mesëm
IV - bSpecialist

**V E N D I M**
**Nr. 554, datë 7.11.2002**

**PËR NJË SHTESË NË RREGULLOREN "PËR ETIKETIMIN E PRODUKTEVE USHQIMORE", TË MIRATUAR ME VENDIMIN NR. 604, DATË 17.11.2000 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 41 të ligjit nr. 7941, datë 31.5.1995 "Për ushqimin", me propozimin e Ministrit të Bujqësisë dhe të Ushqimit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Pas shkronjës "b", në pikën 8.2 "Gjuha" të rregullores "Për etiketimin e produkteve ushqimore", të miratuar me vendimin nr. 604, datë 17.11.2000 të Këshillit të Ministrave, shtohet shkronja "c", me këtë përmbajtje:

"c. Për produktet ushqimore të importuara, të dhënat për emërtimin e produktit, karakteristikat e tij, (natyrën, vetitë, përbërjen etj.), mënyrën e përdorimit, kushtet e ruajtjes, datën e fundit të përdorimit, si dhe emrin dhe adresën e importuesit, duhet të jepen në gjuhën shqipe, në etiketën origjinale ose të vendosen në një etiketë tjetër, së bashku me etiketën origjinale.".

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare dhe hyn në fuqi me 1 janar 2003.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

**V E N D I M**
**Nr. 555, datë 7.11.2002**

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SUEDISË PËR PROJEKTIN "MBËSHTETJE PËR ZHVILLIMIN E REGJISTRIT TË STATISTIKAVE TË BIZNESIT DHE PËRDORIMIN E TYRE NË HARTIMIN E LLOGARIVE KOMBËTARE"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 dhe 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Suedisë për projektin "Mbështetje për zhvillimin e regjistrit të statistikave të biznesit dhe përdorimin e tyre në hartimin e llogarive kombëtare".

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

**MARRËVESHJE**
NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SUEDISË PËR PROJEKTIN "MBËSHTETJE PËR ZHVILLIMIN E REGJISTRIT TË BIZNESIT DHE PËRDORIMIN E TYRE NË HARTIMIN E LLOGARIVE KOMBËTARE"
1 korrik 2002-31 dhjetor 2003

Qeveria e Shqipërisë ( më poshtë e referuar si Shqipëria) dhe Qeveria e Suedisë ( më poshtë e referuar si Suedia) kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1
**Delegimi i të drejtave**

Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Kooperim Ndërkombëtar, SIDA, dhe INSTAT do të kenë të drejtë të përfaqësojnë Qeveritë e tyre përkatëse për çështjet që lidhen me implementimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 2
**Qëllimi dhe objektivat e Marrëveshjes**

Suedia ka vendosur të asistojë INSTAT-in në Shqipëri, duke financuar shërbime konsultimi për Projektin e "Mbështetje për zhvillimin e regjistrit të biznesit, statistikave të biznesit dhe përdorimin e tyre në hartimin e Llogarive Kombëtare" (më poshtë i quajtur Projekt).

Objektivi i përgjithshëm i Projektit është të promovojë procesin demokratik, rritjen ekonomike të qëndrueshme dhe hyrje të sigurta investimesh.

Qëllimi i Projektit është:

Të zhvillojë disa fusha të statistikave ekonomike që lidhen me regjistrin e ndërmarrjeve, të llogarive kombëtare, të statistikave vjetore dhe afatshkurtra, të serive kohore të statistikave të prodhimit dhe të zhvillojë aftësitë për analiza ekonomike, kështu që të lehtësohet vendim-marrja, mbështetur në një informacion statistikor bashkëkohor dhe të besueshëm që plotëson kërkesat e përdoruesve të brendshëm dhe është në përputhje me rekomandimet e EU-së.

Neni 3
**Kontributi i Suedisë**

Suedia do të ofrojë, në përputhje me procedurat parlamentare të saj për dhënien e ndihmës së huaj, fondin mbështetës për implementimin dhe monitorimin e Projektit siç specifikohet në këtë Marrëveshje brenda një shume prej 2595 SWEDISH KRONOR (SEK në mijra).

Shërbimet do të jepen nga SIDA dhe fondet do të kanalizohen përmes organizimit të implementimit të prokuruar.

Neni 4
**Kontributi i Palës Shqiptare**

Shqipëria do të ndërmarrë:

- Të sigurojë përdorimin efektiv të asistencës së vënë në dispozicion me anë të kësaj Marrëveshjeje dhe që kontributi të përdoret për qëllimet e Marrëveshjes.
- Të sigurojë të gjitha burimet të cilat nuk janë të referuara në këtë Marrëveshje si obligime të Suedisë dhe që janë të nevojshme për implementimin eficent të Projektit. Kjo përfshin staf të kualifikuar dhe fonde të mjaftueshme për kostot periodike, po ashtu dhe për investime kapitale.
- Të ndërmarrë përgjegjësinë e koordinimit midis ministrive, donatorëve të tjerë dhe çdo autoriteti tjetër apo institucioni të përfshirë në implementimin e Projektit.

- Të asistojë dhe bashkëpunojë me Suedinë në administrimin dhe kontrollin e brendshëm të burimeve të Projektit dhe në realizimin e çdo revizioni i vlerësuar si i nevojshëm nga Suedia. Inspektimi i arkivës dhe i dokumentacionit, si dhe auditimi i tyre mund të bëhen nga një agjenci e përshtatshme e përzgjedhur nga Suedia.

Neni 5
**Përdorimi i burimeve**

Përdorimi i fondeve të siguruara nga Suedia për Projektin nuk do të pengohet apo të vonohet nga lloji i monedhës, kontrolli mbi kurset e këmbimit apo detyrime të vendosura nga Shqipëria. Asnjë detyrim nuk do të paguhet nga kontributet suedeze.

Suedia nuk duhet të ngarkohet as me taksë doganore, as me taksa shitjeje apo pengesa të tjera të lidhura me to, për të mira apo burime të tjera të siguruara apo të financuara nga Suedia, këto taksa apo kosto do të paguhen nga INSTAT, Shqipëri.

Licenca të nevojshme për importe të financuara nga Suedia duhet të garantohen me shpejtësi nga Shqipëria.

Shqipëria duhet t'i japë Suedisë çdo informacion mbi përdorimin e burimeve të siguruara nga Suedia, për të cilat Suedia mund të pyesë dhe përfaqësues të mundshëm të Suedisë të vizitojnë dhe të studiojnë aktivitetet dhe të inspektojnë pasuritë, të mirat, arkivën dhe dokumentet. Inspektimi i arkivës dhe dokumentacionit, po ashtu si dhe revizionimi mund të realizohen nga çdo agjenci e përshtatshme e zgjedhur nga Suedia.

Suedia do të japë informacion Shqipërisë për kostot e shkaktuara nga Suedia për Projektin.

Shqipëria dhe Suedia bien dakord të kooperojnë për parandalimin e korrupsionit brenda dhe përmes Projektit.

Shqipëria dhe Suedia ndërmarrin marrjen e masave të shpejta ligjore në vendet e tyre përkatëse për të ndaluar, hetuar dhe detyruar çdo palë të dyshuar për korrupsion ose shpërdorime të tjera të qëllimshme të burimeve të Projektit.

Neni 6
**Kushtet për zhvendosjen e personelit dhe të institucioneve në Shqipëri dhe kompanitë konsultante**

Kur personeli, insitucionet, kompanitë konsultante apo persona të tjerë ligjorë zhvendosen nga vende të tjera veç Shqipërisë, në Shqipëri, të angazhuar nga Suedia për të realizuar detyrat në Shqipëri brenda kuadrit të Projektit:

- Ata do të kenë të drejtën të importojnë dhe të rieksportojnë, të lirë nga taksa doganore apo detyrime të tjera, pajisje profesionale dhe të mira të cilat do t'u nevojiten për të përmbushur sipërmarrjen e tyre, apo të shesin pajime të tilla brenda Shqipërisë përkundrejt pagesave të doganës dhe detyrimeve të tjera, kur nuk nevojiten më për të kryer shërbimet.

- Ato do të kenë të drejtën të hapin llogari të jashtme banke dhe t'i përdorin ato për përmbushjen e sipërmarrjes së tyre. Përdorimi eficent i llogarisë nuk do të pengohet nga kontrolle të kursit të këmbimit të monedhave, dhe bilancet në këto llogari të jashtme do të transferohen në mënyrë të lirë në çdo monedhë të konvertueshme.

- Ata do të përjashtohen nga të gjitha detyrimet për të regjistruar veten në Shqipëri për autorizime profesionale, taksa apo arsye të tjera, dhe nuk do të jenë nën asnjë obligim për të dhënë informacion autoriteteve të tatimeve të Shqipërisë përderisa ata të mos drejtojnë aktivitet biznesi në Shqipëri që nuk është pjesë e kësaj kontrate.

- Trajtim i menjëhershëm dhe dhënie pa pengesa i vizave me shumë hyrje-dalje për të tërë kohëzgjatjen e Marrëveshjes së tyre.

- Lëvizje e lirë brenda vendit dhe e drejta për të hyrë dhe për të dalë jashtë vendit në masën e nevojshme për implementimin e Projektit.

- Lëshime të menjëhershme për të gjitha lejet e kërkuara si leje qëndrimi, leje pune dhe profesioni, po ashtu dhe përjashtime nga kufizimet e emigrimit dhe regjistrimet e huaja gjatë periudhës që ato mbulohen nga Marrëveshja.

- Akses pa pengesa në shërbimet mjeksore me cilësinë më të lartë të disponueshme në vend, pavarësisht nëse ato janë shërbime publike apo private. Faturat e këtyre shërbimeve do të paguhen më vonë nga Suedia. Kostot do të financohen nga fondet suedeze për projektin me të cilin është i lidhur personi që ka shfrytëzuar ato shërbime.

- Përjashtime nga taksa mbi të ardhurat personale dhe çdo taksë tjetër e drejtpërdrejtë lidhur me pagesat e rrogave të tyre (personelit, konsultuesit dhe institucioneve joshqiptare) të bëra nga SIDA, apo nga ndonjë punonjës joshqiptar që ka ndërmarrë realizimin e shërbimeve apo shpërndarjen e të mirave me anë të një kontrate të bërë me SIDA-n në mënyrë të drejtpërdrejtë apo si një nënkonsultant.

- Kushtet për personelin e zhvendosur në Shqipëri do të aplikohen edhe për bashkëshortët e tyre, bashkëvendasit dhe vartësit e tyre.

Neni 7
**Kushtet për kontributin suedez**

1. Vetëm kostot për aktivitetet e realizuara gjatë periudhës 1 korrik 2002 deri në 31 dhjetor 2003 mund të financohen nga kontributi suedez për shërbime konsultimi për Projektin. Pas një periudhe prej 6 muajsh nga data e fundit, kontributi për Projektin në këtë Marrëveshje nuk do të jetë i disponueshëm për financimin e shërbimeve të konsultimit. Nëse aktivitetet pas dhjetorit 2003 nuk do të organizohen nën një marrëveshje të re, personeli mund të financohet nën këtë Marrëveshje në lidhje me kostot gjatë periudhës së përcaktuar në kontratat individuale të punës, maksimumi deri në gjashtë muaj, duke siguruar atë që autoritetet e caktuara kanë rënë dakord, në kohën e punësimit, ose në një zgjatje të kontratës, për të shtrirë periudhën e punësimit përpara datës së përfundimit të mësipërme.

2. Suedia, në çdo kohë, mund të pengojë dhënien e disbursimeve për shërbimet e konsultimit: nëse ndodhin devijime nga planet e rëna dakord apo nga buxheti; nëse ka shpërdorime të fondeve apo të burimeve të tjera; nëse burimet që duhet të sigurohen nga Shqipëria nuk vihen në dispozicion sipas planifikimit; nëse objektivat e Projektit janë të rrezikuara; apo nëse Projekti zhvillohet në mënyrë të pafavorshme përsa i përket objektivave në çdo aspekt tjetër të rëndësishëm.

Neni 8
**Prokurimi**

Suedia do të prokurojë shërbime për implementimin e Projektit në përputhje me "Direktivat e përgjithshme mbi prokurimin e të mirave, punëve dhe shërbimeve nën asistencën financiare të Suedisë (miratuar më 19 dhjetor 1997), apo çdo dokument tjetër nga SIDA që mund ta zëvendësojë atë.

Neni 9
**Raportime dhe procedura të tjera implementimi**

Menaxhimi i Projektit do të sigurojë raporte fillestare, periodike dhe përfundimtare tek Përfituesi (Instituti i Statistikës) për komente.

Pavarësisht nga rutina e raportimit të rënë dakord, Palët duhet të informojnë menjëherë njëra-tjetrën nëse një situatë bën që Projekti nuk do të realizohet siç është rënë dakord.

Neni 10
**Referenca të marrëveshjeve të tjera**

Kooperimi midis Palëve nën këtë Marrëveshje është gjithashtu i qeverisur nga:

- Marrëveshja mbi Termat e Përgjithshme dhe Kushtet për Kooperimin i Zhvillimit midis Qeverisë së Suedisë dhe Qeverisë së Shqipërisë për periudhën 2001-2005 kur të hyjë në fuqi;
- Marrëveshja e Kooperimit të Zhvillimit për periudhën 2001-2002, kur të hyjë në fuqi;
- çdo marrëveshje që mund të zëvendësohet ose rishikimi i Marrëveshjes në fjalë.

Neni 11
**Shpërndarja e Marrëveshjes**

Palët ndërmarrin shpërndarjen e kopjeve të Marrëveshjes në të gjitha ministritë e tyre, autoritetet dhe institucionet e tjera, të përfshira në Projektin e kooperimit ose në rastet kur kërkohet informacion për përmbajtjen.

Neni 12
**Përfundimi**

Kjo Marrëveshje mbetet e vlefshme deri në 30 qershor 2004, po të mos ketë njoftim të shkruar nga secila Palë dërguar 6 muaj përpara.

Neni 13
**Hyrja më fuqi**

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi pasi Palët të njoftojnë përfundimin e procedurave të tyre të brendshme të miratimit.

Dy origjinalet e tekstit të kësaj Marrëveshjeje të shkruara në gjuhën angleze janë nënshkruar.

**V E N D I M**
**Nr. 556, datë 7.11. 2002**

**PËR SHKËMBIMIN E VILËS NR. 55, PRONË E SHTETIT SHQIPTAR, ME VILËN NR. 6, PRONË E MBRETËRISË SË BASHKUAR TË BRITANISË SË MADHE DHE IRLANDËS SË VERIUT**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4, 5, 6, 10, 11, 13 dhe 14 të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001 "Për pronat e paluajtshme të shtetit" dhe të nenit 757 të ligjit nr. 7850, datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë", me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shkëmbimin e vilës nr. 55, së bashku me truallin nën të dhe oborrin rrethues, pronë e Shtetit Shqiptar, me adresë: Rruga "Skënderbeu", Blloku i Ambasadave, Tiranë, me vilën nr. 6, së bashku me truallin nën të dhe oborrin rrethues, pronë e Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandës së Veriut, me adresë: Lagja "Tirana e Re", rruga "Donika Kastrioti", Tiranë.
2. Shkëmbimi i këtyre dy vilave të kryhet pa shpërblim apo kompensim mbi vlerën e këtyre pronave.
3. Shkëmbimi të realizohet nëpërmjet një kontrate shkëmbimi, e cila të nënshkruhet për Palën Shqiptare nga një përfaqësues i Ministrisë së Punëve të Jashtme.
4. Pas shkëmbimit, vila nr. 6 të administrohet nga Ministria e Punëve të Jashtme, nëpërmjet Drejtorisë së Shërbimit të Trupit Diplomatik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

**V E N D I M**
**Nr. 559, datë 7.11.2002**

**PËR MIRATIMIN E LEJES SË FUNKSIONIMIT TË INSTITUCIONIT ARSIMOR, JOPUBLIK "AMARO TAN"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 44 të ligjit nr. 7952, datë 21.6.1995 "Për sistemin arsimor parauniversitar", të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe të Shkencës, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Miratimin e lejes së funksionimit të institucionit arsimor, jopublik fetar "Amaro Tan", të nivelit parashkollor, kopësht dhe shkollë, të ciklit të ulët 8-vjeçar, klasa I-IV, në qytetin e Pogradecit.

2. Ngarkohet Ministria e Arsimit dhe e Shkencës për të përcaktuar modalitetet e funksionimit të këtij insitucioni arsimor, jopublik, dhe për të ndjekur zbatimin e dispozitave ligjore e nënligjore për arsimimin, edukimin, formimin dhe kualifikimin në këtë institucion.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

## V E N D I M
## Nr. 564, datë 13.11.2002

## PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË RUMANISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN SANITARE VETERINARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 17 e 23 të ligjit nr. 8371, datë 9.7.1998 "Për lidhjen e traktateve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare" me propozimin e Zëvendëskryeministrit dhe Ministër i Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës të Rumanisë për bashkëpunimin në fushën sanitare veterinare.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Fatos Nano**

## MARRËVESHJE
## NDËRMJET QEVERISË SË REPUBLIKËS TË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS TË RUMANISË PËR BASHKËPUNIMIN NË FUSHËN SANITARE VETERINARE

Qeveria e Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Rumanisë, më poshtë të quajtura Palë Kontraktuese;

Marrin vendim për të zgjeruar dhe zhvilluar bashkëpunimin reciprok në fushën e veterinarisë;

Me qëllim që të sigurojnë një mbrojtje të përshtatshme kundër sëmundjeve të kafshëve dhe atyre të shkaktuara prej produkteve me origjinë shtazore, të karakterizuara nga një shëndet jo i mirë;

Të prirura nga dëshira për të zhvilluar më tej lidhjet midis dy vendeve, për të lehtësuar tregtinë e ndërsjellë të kafshëve, materialit biologjik artificial, embrione, vezë për riprodhimin, produkte me origjinë shtazore, ilaçe dhe produkte të tjera, të cilat mund të ndikojnë në shëndetin e kafshëve;

Vendosën të lidhin këtë Marrëveshje.

Neni 1

Palët Kontraktuese do të bashkëpunojnë lidhur me mbrojtjen e territoreve të shteteve të tyre kundër transmetimit të sëmundjeve të kafshëve gjatë importit, eksportit dhe tranzitit të kafshëve,

materialit biologjik artificial, embrione, vezë për riprodhim, produkte me origjinë shtazore, ilaçe dhe produkte të tjera që mund të ndikojnë në shëndetin e kafshëve.

Neni 2

Autoritetet sanitare veterinare të Palëve Kontraktuese kompetente në zbatim të kësaj konvente janë si vijon:

1. Drejtoria Veterinare e Ministrisë së Bujqësisë dhe Ushqimit e Republikës së Shqipërisë.
2. Agjencia Kombëtare Sanitare Veterinare e Ministrisë së Bujqësisë së Rumanisë.

Neni 3

Autoritetet kompetente sanitare veterinare të Palëve Kontraktuese do të bien dakord mbi aktivitete të përbashkëta, me qëllim që të thjeshtojnë ekzekutimin e procedurave sanitare veterinare për importimin, eksportin dhe tranzitin e kafshëve, materialit biologjik artificial, embrioneve, vezëve për riprodhim, produkteve me origjinë shtazore, barnave dhe produkteve të tjera për përdorim në mjekësinë veterinare, ushqimeve të blegtorisë dhe produkteve të tjera që i nënshtrohen kontrollit sanitar veterinar në kufi. Aktivitetet dypalëshe do të aprovohen duke marrë në konsideratë rregullat e legjislacionit shqiptar dhe rumun, si dhe ato të Bashkimit Europian dhe OBT-së.

Neni 4

Autoritetet sanitare veterinere kompetente do t'i japin njëri-tjetrit informacionin mbi:

a) gjendjen në territoret e shteteve të tyre, të sëmundjeve të specifikuara në listën A të Zyrës Ndërkombëtare të Epizootive duke përfshirë emrin e specieve, numrin e kafshëve të prekura nga sëmundjet dhe zonat e përhapjes së sëmundjeve, bazën për diagnozën dhe veprimtaritë e ndërmarra me qëllim që të kontrollohen sëmundjet;

b) sëmundjet infektive të kafshëve, të specifikuara në listat A dhe B të Zyrës Ndërkombëtare të Epizootive, duke shkëmbyer çdo muaj buletinet;

c) kushtet sanitare veterinare dhe modelet e certifikatave sanitare veterinare, që përcaktojnë kushtet e importit, eksportit dhe tranzitit të kafshëve, materialet biologjike artificiale, embrione, vezë për riprodhim, produkte me origjinë shtazore, barna dhe produkte të tjera për përdorim në mjekësinë veterinare, ushqime për blegtorinë dhe produkte të tjera, të cilat mund të ndikojnë në shëndetin e kafshëve.

2. Autoritetet kompetente sanitare veterinare të Palëve Kontraktuese do të informojnë njëri-tjetrin, menjëherë, mbi masat e prandalimit të ndërmarra në rast të sëmundjeve të specifikuara në listën A të Zyrës Ndërkombëtare të Epizootive që ndodhin në territoret e vendeve fqinjë.

Neni 5

1. Palët Kontraktuese do të mbështesin bashkëpunimin ndërmjet autoriteteve kompetente veterinare dhe institucioneve shqiptare dhe rumune, që shfrytëzojnë arritjet shkencore dhe teknike në fushën sanitare veterinare përmes:

a) shkëmbim përvoje dhe njohurie në lidhje me çështjet e profesionit veterinar;

b) shkëmbim informacioni dhe vizita pune të bëra nga personeli shkencor dhe specialist;

c) shkëmbim i revistave profesionale dhe i botimeve të tjera sanitaro-veterinare;

d) shkëmbim informacioni në lidhje me aktivitetet sanitaro-veterinare, akte ligjore, rregullat dhe rregulloret e botuara në këtë fushë;

e) shkëmbim informacioni, rregulloresh dhe specialistësh në fushën e përpunimit, kontrollit, regjistrimit dhe tregtimit të produkteve veterinare.

2. Palët Kontraktuese do të lejojnë autoritetet e tyre kompetente veterinaro-sanitare të kryejnë kontrolle të ndërsjella në qendrat e eksportimit të kafshëve, materialit biologjik artificial, embrione, vezë për riprodhim, produkte me origjinë shtazore, barna dhe produkte të tjera për përdorim në mjeksinë veterinare, ushqimeve për blegtorinë dhe produkte të tjera, të cilat mund të ndikojnë në shëndetin e kafshëve.

Neni 6

Shpenzimet në zbatim të klauzolave të kësaj Marrëveshjeje do të mbulohen prej secilës Palë Kontraktuese, duke respektuar legjislacionin e tyre.

Neni 7

1. Përfaqësuesit e autoriteteve kompetente veterinaro-sanitare të Palëve Kontraktuese do të takohen sa herë që të jetë e nevojshme në vendin dhe kohën që do të bien dakord në mënyrë të ndërsjellë.

2. Çdo marrëveshje lidhur me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje do të zgjidhet përmes bisedimeve të Palëvë Kontraktuese.

3. Në rast se mirëkuptimi nuk është arritur gjatë bisedimeve të përmendura në pikën 2, mospërputhjet ndërmjet Palëve Kontraktuese në zbatimin e Konventës do të shqyrtohen nga një komision i përbashkët. Komisioni do të përbëhet nga dy veterinerë dhe një jurist nga secila Palë Kontraktuese.

Komisioni do të takohet me kërkesën e njërës nga Palët Kontraktuese brenda 30 ditëve nga data e kërkuar për një takim të tillë nga njëra nga Palët Kontraktuese, në territorin e vendit të vet. Takimi do të drejtohet në mënyrë të alternuar nga një anëtar i secilit delegacion.

Neni 8

Kjo Marrëveshje nuk cenon të drejtat dhe detyrimet e Palëve Kontraktuese që rezultojnë prej marrëveshjeve të tjera ndërkombëtare të përfunduara nga Palët Kontraktuese në fushën veterinaro-sanitare.

Neni 9

Marrëveshja do të hyjë në fuqi në ditën e 60-të pas datës së fundit të njoftimit të fundit përmes të cilit Palët Kontraktuese do të informojnë njëri-tjetrin për përfundimin e procedurave të kërkuara nga legjislacioni i tyre për të hyrë në fuqi.

Neni 10

Kjo Marrëveshje është bërë për një periudhë 5-vjeçare dhe do të zgjatet automatikisht për një peridhë të re 5-vjeçare, në qoftë se njëra nga Palët Kontraktuese nuk njofton Palën tjetër Kontraktuese të paktën 6 muaj para skadimit të vlefshmërisë së periudhës përkatëse rreth qëllimit të saj për të përfunduara Marrëveshjen.

Neni 11

Në datën që kjo Marrëveshje ndërmjet Qeverisë së Republikës të Shqipërisë dhe Qeverisë së Rumanisë do të hyjë në fuqi, konventa veterinaro-sanitare ndërmjet Qeverisë së Republikës Popullore të Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës Socialiste të Rumanisë, e nënshkruar në Tiranë më 22 mars 1975, humbet vlefshmërinë e saj.

Nënshkruar në Bukuresht më 6.12.1999, në dy kopje origjinale secila në shqip, rumanisht dhe anglisht, të gjitha tekstet duke qenë në mënyrë të barabartë autentike.

Në rast ndryshimi në përkthim, teksti anglisht do të ketë prioritet.

**K Ë R K E S Ë**

Fatmira Rexhepi, lindur më 1963 dhe banuese në Kavajë, kërkon shpalljen të vdekur të Muhamet Sami Rexhepit (bashkëshort i kërkueses), prindërve të tij Sami Kasem Rexhepi, Fatime

Abaz Rexhepi dhe vajzave të tyre Mihase Sami Rexhepi e Lutfije Sami Rexhepi.

KËRKUESE
**Fatmira Rexhepi**

**Fletorja Zyrtare** gjendet:

- në çdo njësi postare të çdo qyteti;
- pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare:
Rr.Qemal Stafa, pranë ndërtesës së Prokurorisë së Përgjithshme.

Pranë **Qendrës së Publikimeve Zyrtare** mund të gjeni:
- Kodin Penal (të azhurnuar);
- Kodin e Procedurës Penale (të azhurnuar);
- Përmbledhjen e legjislacionit në fushën e transporteve (Kodin Rrugor dhe ligjin për transportet, e azhurnuar);




U dorëzua për shtyp më 18. 11. 2002
Doli nga shtypi më 19. 11. 2002

Tirazhi: 4250 copë Formati: 60x88/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2002

Çmimi: 150 lekë